

## Edukimi Mjedisor



Gjatë muajit Qershor në kuadër të Projektit JICA janë zhvilluar dy mbledhje të grupeve të punës për Edukimin Mjedisor dhe Ekoturizmin.

Qëllimi kryesor i këtyre mbledhjeve ishte diskutimi me anëtarët e grupit të punës mbi prodhimin e videos promovuese dhe hartave orjentuese për parkun, si dhe për kodin e sjelljes në programin e Eko Turizmit.

Programi i Edukimit Mjedisor në finalizimin e menuve që do të përfshihen në kurrikulën shkollore në këtë vit të ri akademik.

Puna për Edukimin Mjedisor dhe Eko Turizmin do të vazhdojë me AdZM Fier dhe Shkollat Lokale për planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve në PKDK si dhe finalizimin e menuve. Edhe për Eko Turizmin do të vijojë puna për finalizimin e videos promovuese dhe hartave për parkun.

## Bujqësia e Qëndrueshme

Në kuadër të Projektit JICA, për promovimin e Bujqësisë së Qëndrueshme në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta më muajin Qershor, në fshatin Xëng u organizua trajnimi i katërt për bujqësinë e qëndrueshme.

Ekspertë të bujqësisë, profesorë dhe studentë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, ekspertë të JICA-s ndanë informacionet e tyre me fermerët për një bujqësi organike dhe të qëndrueshme.

Fermerët u shprehën ekspertëve problemet e tyre dhe të gjithë së bashku diskutuan se si të përmirësojnë mënyrën e tyre të prodhimit.

Trajnime të tjera do të zhvillohen në fshatrat e PKDK nga projekti JICA për bujqësi të qëndrueshme për të përhapur sa më shumë idenë e prodhimit organik me të gjithë fermerët.



## BULETINI INFORMATIV

PER MUAJIN QERSHOR 2023

Projekti për Ngritjen e Kapaciteteve Për Përmirësimin e Menaxhimit të Bazuar në Ekosistem në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta



Administrata e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta  
Adresa: Zyrat e Parkut 9022 Divjakë, Lushnjë  
Tel: (+355) 69 890 0540  
Email: dknpmmedia@hotmail.com

SCAN ME



Instagrami i  
Projektit JICA

SCAN ME



Facebook  
AdZM Fier

## Komiteti i Menaxhimit të Parkut



Në muajin Qershor në Prefekturën e Fierit u zhvillua mbledhja e Komitetit të Menaxhimit të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta .

Mbledhja u kryesua nga Prefekti i Fierit, ku morën pjesë Zv.Prefekti i Tiranës, zv/kryetar i Bashkisë Divjakë dhe zyrtarë nga sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe turizmit, stafi i zyrës së menaxhimit të parqeve dhe ekspertë të projektit JICA.

Tema kryesore e agjendës ishte prezantimi i raportit të punës së AdZM Fier që nga takimi i fundit i Nëntorit 2022 dhe arritjet e projektit JICA. Kryekëshilltari, Z. Koji Asano dhe Koordinatori Teknik, Dr. Sajmir Hoxha i prezantuan KMP-së në detaje arritjet e projektit në të gjithë komponentët, të cilat u vlerësuan prej tyre.

Anëtarët e komitetit diskutuan të gjithë së bashku për tema dhe probleme të ndryshme që lidhen me parkun dhe propozuan zgjidhje të ndryshme.

## Rosa Kërre

Rosa kërre është një nga rosat më të vogla, ato nuk zhyten plotësisht për t'u ushqyer. Ka një pendë të larmishme, vezulluese që ndryshon sipas gjinisë dhe moshës.

Kjo rosë gjendet në ligatinat e pasura me lëndë ushqyese dhe bimësi. Preferon ujëra jo shumë të thella, si pellgje, laguna, rrjedha ujore me rrjedhje të ngadaltë.

Kryesisht ka një dietë barngrënëse, por hanë edhe larvat e insekteve ujore.

Folenë e ndërtojnë mes bimësisë së thatë e të dendur dhe është e mbushur me pupla.

Periudha e migrimit pas riprodhimit shkon nga mesi i Gushtit deri në Shtator, ndërsa periudha e migrimit para-riprodhues fillon në Janar dhe zgjat deri në Prill.

Në Shqipëri gjendet në numër të madh veçanërisht në PKDK dhe kërcënimi kryesor për këtë rosë është gjuetia.



## Drenja e Fushës

Drenja e fushës ka ngjyrën e rërës sipër në kurriz dhe ngjyrë të bardhë poshtë në pjesën e barkut, këmbë të gjata, të holla ngjyrë rozë ose kafe të lehtë. Ka një ndërtim të hollë dhe të thjeshtë.

Ky zog gjendet në livadhet e thata, grykat, kullotat e degraduara, dunat ranore dhe brigjet e lumenjve. Kryesisht ushqehet me jovvertebrorë, vezë, larva dhe insekte të rritura.

Migrimi pas-riprodhimit ndodh midis mesit të Gushtit dhe Tetorit, ndërsa migrimi para-riprodhues bëhet në Prill.

Në Shqipëri është një specie folezuese dhe mund të vërehet në zona të hapura dhe të thata në PKDK.

Duke qenë se preferon zonat e hapura, ekzistenca e këtij zogu kërcënohet nga pyllëzimi. Ai kërcënohet gjithashtu nga përdorimi i plehrave dhe lëndëve ushqyese.

